Shefki Ollomani

ZGJOHU, NGRITU SHQIPËRI!

(Poezi të Zgjedhura: 2001-2009)

Editor
Azam Dauti

Recensent
Fadil Curri

Shefki Ollomani

ZGJOHU, NGRITU SHQIPËRI!

(Poezi të Zgjedhura: 2001-2009)

Shkupi
Shkup, 2009

VARGJET E MIA

Mbi një letër derdha vargjet
Vargje zemre valë-valë,
Hapen portat, gëzohen pragjet
Brenda hyn shpirti me mallë.

Kullë për kullë e shtëpi për shtëpi
Peshë e çojnë trimen rini,
Vatër më vatër, oxhak më oxhak
Vargjet e mia valojnë - Bajrak.

Vargjet e mia
Frymëzim nga Perëndia,
I këndojnë Lirisë
I falen Shqipërisë.

Vargjet e mia
Melhem për plagë,
Vargje si shkëndia
Barut e flakë.

Vargjet e mia
Këngë e betim,
Vargje si stuhia
Qëndresë e marshim.

Vargjet e mia:
Vargje melodike,
Vargje magjike,
Vargje vullkanike.

Vargjet e mia:
Vargje arbërore,
Bukuri lulebore,
Besë burrërore.

Vargjet e mia:
Vargje shqiptare,
Vargje kushtrimtare,
Prijnë flamurtare.

Vargjet e mia
Visare kombëtare,
Vargjet e mia
Vargje çlirimtare.

Vargjet e mia
Lule përmbi gur,
Vargjet e mia
Shqipe në Flamur.

Vargjet e mia
Vargje si liria
Maliherë e dyfekë
Rrethatore me fyshekë
Herë baladë, herë simfoni
Rreze drite mbi Shqipëri.

Vargjet e mia:
Rrënjë pellazgjike
Trungje ilirike
Degë Arbërie
Fryte Shqipërie
Pemë përjetësie.

Vargjet e mia
Vargje njerëzore,
Vargjet e mia
Vargje popullore.

SONTE

Sonte gjumë unë nuk kam
Sonte vargjet fund nuk kanë,
Sonte zemra po m'gufon
Sonte shpirti po më trazon.

Sonte mendja nuk po lidhet
Sonte trupi po më dridhet,
Sonte frymëzimi po ndriçon
Sonte pena po flakëron.

Sonte nata është e gjatë
Sonte nuk bëhem rehat,
Sonte unë do rri i zgjuar
Sonte kam për të shkruar.

Kur këndoi gjeli n'agim
U zgjova befas, me rrëmbim
Kotur mbi kompjuterin tim
Lodhur, mpirë,... trupi im.

ËNDRRA PËR SHQIPËRINË ETNIKE

Ëndrra s'është insinuatë,
ajo është imagjinatë.
Ëndrra s'është iluzion,
ajo është vizion.
Ëndrra s'është një vegim,
ajo është një përjetim.
Ëndrra s'është veç e trishtueshme,
ajo është edhe e gëzueshme.
Ëndrra s'është fantazi foshnjore,
ajo është vërtetësi shkencore.

Ëndrra është ideal e frymëzim,
mençuri e përkushtim.
Ëndrra është opcion e parashikim,
aspiratë e synim.
Ëndrra është qëllim e largpamësi,
këmbëngulje e dituri.
Ëndrra është durim e qëndresë,
burrëri e besë.
Ëndrra është guxim e trimëri,
betim e besnikëri.
Ëndrra është sakrificë e dashuri,
vetëdije e krenari.

Ëndrra është kushtrim e shtegtim,
është marshim e dyluftim.
Ëndrra është sulm e shpresë,
është flijim e mbijetesë.
Ëndrra është fitore e ardhmëri,
është çlirim e përjetësi.
Ëndrra është besim e atdhedashuri
është vetëvendosje e liri.

Ëndrra për Shqipërinë Etnike,
është luftë heroiko-epike.
Ëndrra për Shqipërinë Etnike,
është kombëtare dhe historike.
Ëndrra për Shqipërinë Etnike,
është e lashtë dhe antike.
Ëndërra për Shqipërinë Etnike,
është ëndërr pellazgjiko-ilirike.
Ëndrra jonë e Madhe Kombëtare,
është Bashkimi i Trojeve Shqiptare.

DUA

Dua dielli të rrezojë
Dua hëna të ndriçojë
Dua njerëzit të gëzojnë
Dua fëmijtë të lodrojnë.

Dua kafshët të frymojnë
Dua zogjtë të këndojnë
Dua peshqit të notojnë
Dua insektet të gjallërojnë.

Dua drunjtë të gjethojnë
Dua bimët të gjelbrojnë
Dua lulet të lulëzojnë
Dua pemët të frutojnë.

Dua era të freskojë
Dua uji të gurgullojë
Dua zjarri të flakërojë
Dua toka të mbijetojë.

Dua shumë, dua tepër
Dua t'shembet botë e vjetër
Dua jeta të triumfojë
Dua paqa të mbizotërojë.

URREJ...

Urrej pushtuesët vrastarë,
që janë të egër e barbarë!
Që shkelën atdheun tim,
që vranë e prenë pa pushim!
Që dogjën e djegin prore,
që zhdukin çka u bjen përdore!
Që prush e tym përhapin,
që kurrë s'e ndalin vrapin!

Urrej armiqtë dhe robërinë,
që copa-copa bënë Shqipërinë!
Që lirinë na grabitën,
që na nxinë jetën e ditën!
Që Diellin na e zunë,
që dhe Hënën na përzunë!
Që errësirën na e sollën,
që përçarjen na e mbollën!

Urrej shqiptarët tradhtarë,
që pëllasin si gomarë!
Që me zell shërbejnë armikun,
që pranojnë vatrën e fikun!
Që çdo ditë shesin Atdheun,
që mohojnë Skënderbeun!
Që s'kanë turp, as burrëri,
që s'kanë zemër, as njerëzi!

NUK SHKRUHET...

Nuk shkruhet sa për të shkruar
Sa herë që të kujtohet,
Shkruhet për të dëshmuar
Atëherë kur luftohet,
Kur je i frymëzuar
Nga liria që fitohet.

Nuk shkruhet për inatë
As për emër e zili,
Shkarravitje ditë e natë
Mbi të bardhën vetëm zi!
Therë me thikë e pret me shpatë
Arrogant, kapadahi!

Nuk shkruhet për para
Me mburrje për hava!
Shkruhet nga dashuria
Për heronj e dëshmorë,
Kur qëndron Shqipëria
Si në diell, si në borë.

KEMI...!

Kemi Atdhe e Mëmëdhe,
Jemi t'Parët mbi këtë Dhe.

Kemi Atë e kemi Mëmë,
Diell e Yje na kanë zënë!

Kemi Babë e kemi Nënë,
Vrarë, djegur, të përzënë!

Kemi Farë e kemi Fis,
Shqipëria katandis!

Kemi Duar e kemi Këmbë,
Çdo armik na han me dhëmbë!

Kemi Sy e kemi Veshë,
Që të dy i kem' shti n'leshë!

Kemi Zemër e kemi Kokë,
S'i përdorim për këtë Tokë!

Gjithëçka kemi, Asgjë s'kemi,
Vëlla me Vëlla ndaras jemi!

Krah për krah nuk luftojmë,
Njëri-tjetrit s'i ndihmojmë!

S'ndihmon Zot e Allah!
Jem' "jetima për gjynah"!

UNË DHE KOMBI

Unë dhe Ti, Ti dhe Unë
Jem' si deti i pafund,
Të Dy bashkë asgjë s'na tund
Kurrë armiku nuk na mund.

Të Dy tok, dora-dora
S'na ndal shiu, as dëbora,
Të gjithë Botës ia bëjmë fora
Si Kastrioti e Ismail Vlora.

Unë dhe Ti – një Flamur
Qëndrojmë bashkë - gur mbi gur,
Të Dy tok bëjmë një Mur
Që nuk shembet sot as kurrë,
Nuk ka forcë që na nda
Të Dy bashkë bëjmë Kala.

Ti dhe Unë - një Shpirtë kemi
Unë dhe Kombi një Trup jemi,
Të Dy bëjmë një Tërësi
Një Atdhe, një Kombësi,
Të pamposhtur në histori
Pellazgji dhe Iliri,
Arbëri dhe Shqipëri
Të pavdekshme në Gjithësi.

KOT E KANË...

Kot e kishin pushtuesit e vjetër
Kot e kanë pushtuesit e rinj
Kot na mbajnë në shënjestër
Kot po digjen si qirinj.

Kot e kanë gjithë barbarët
Kot e kanë greko-sllavët
Kot e kanë dhe ndërkombëtarët
Se nuk mposhten dot Shqiptarët.

Kot e kanë matrapazët
Kot e kanë dhe xhambazët
Kot e kanë demagogët, tregtarët
Kot e kanë karrieristët, bajraktarët
Kot e kanë mercenarët, tradhtarët
Kot e kanë dhe ndërkombëtarët.

Nuk ka pranga e zinxhirë
Që na mbajnë n'errësirë,
S'ka "Marrëveshje" as "Korniza"
Që na fusin në therra e driza,
Nuk ka "Pako" as paketa
Shqiptari don trojet e veta.

S'ka "Traktate" as "Deklarata"
S'na mashtrojnë me urata,
Nuk ka "Pika", nuk ka thika
Nuk na ndal dhuna, as frika,
Është Shqiptari trim me fletë
Shqipërinë Etnike e bën vetë.

SHKRUAJ...

Shkruaj kur mendja logjikon,
Shkruaj kur shpirti mediton,
Shkruaj kur zemra këndon,
Shkruaj kur trupi vallëzon.

Shkruaj kur syri loton,
Shkruaj kur gjaku pikon,
Shkruaj kur tragjedia luhet,
Shkruaj kur jeta shuhet.

Shkruaj kur lufta fillon,
Shkruaj kur liria triumfon,
Shkruaj kur paqa fiton,
Shkruaj kur populli feston.

Shkruaj kur më vlon frymëzimi,
Shkruaj kur më gufon gëzimi,
Shkruaj kur më kap trishtimi,
Shkruaj kur më zen zemërimi.

Shkruaj kur dita agon,
Shkruaj kur Dielli rrezon,
Shkruaj kur nata errëson,
Shkruaj kur Hëna ndriçon.

Shkruaj kur bjen borë apo shi,
Shkruaj kur gjëmon me stuhi,
Shkruaj kur shpërthen vargu,
Shkruaj kur ka dasma pragu.

Shkruaj nga dashuria,
Shkruaj nga mërzia,
Shkruaj nga malli,
Shkruaj nga halli,
Shkruaj nga morali,
Shkruaj nga ideali.

Shkruaj kur lulet plot aromë çelin,
Shkruaj kur bari mbulon zabelin,
Shkruaj kur dushku shpërthen,
Shkruaj kur vjeshta vjen.

Shkruaj në dimër e në verë,
Shkruaj pareshtur, përherë,
Shkruaj se aty gjejë pushim,
Shkruaj me bindje e përkushtim,
Shkruaj se kam besim e shpresë,
Shkruaj atë që shohë e ndjejë vetë.

TOKË E MBJELLË...
(Kosovës dardane)

Tokë e mbjellë me heronj,
tokë e mbrojtur me thonj.

Tokë e mbjellë me dëshmorë,
tokë e kënduar nga dasmorë.

Tokë e mbjellë me përmendore,
tokë e bukur, engjëllore.

Tokë e mbjellë me luftëtarë,
tokë e mbrojtur nga atdhetarë.

Tokë e mbjellë me kështjella,
tokë e fortë me rrënjë të thella.

Tokë e mbjellë me burra fisi,
tokë e bardhë si bora e plisi.

Tokë e mbjellë me plumba,
tokë e mbushur me pëllumba.

Tokë e mbjellë me shtrëngata,
tokë e skuqur nga prushi e flaka.

Tokë e mbjellë me fortesa,
tokë e fortë porsi besa.

Tokë e mbjellë me zambak,
tokë e njomur me gjak.

Tokë e mbjellë me çlirimtarë,
tokë e lartësuar nga fitimtarë.

Tokë e mbjellë me kaçakë,
tokë e zjarrtë porsi gacë.

Tokë e mbjellë me shqiptarë,
tokë e stolisur me flamurtarë.

Tokë e mbjellë me llogore,
tokë e lidhur dorë-përdore.

Tokë e mbjellë me trimëri,
tokë e veshur me lavdi.

Tokë e mbjellë me kreshnikë,
tokë e shqiptarëve etnikë.

Tokë e mbjellë me këngë epike,
tokë e lashtë pellazgjike.

Tokë e mbjellë me lulkuqe,
tokë e bukur si burbuqe.

Tokë e mbjellë me liri,
tokë ilire, Shqipëri.

Tokë e mbjellë me shkëndija,
tokë e bekuar nga Perëndia.

Nga një shekull - në shekullin tjetër
Që nga toka deri në re
Dardani e Vjetër
Kosovë e Re.

JETA IME

Jeta është dhuratë hyjnore,
Është Parajsë përrallore.
Jeta është për t'u jetuar:
Herë duke kënduar
Herë duke vajtuar
Herë duke medituar.

Jeta ime - ylber me ngjyra,
Reflekton si pasqyra.
Jeta ime - bardhë e zi,
Atom drite në Gjithësi.

Herë më ëmbëlson, herë më vreros!
Herë më zbardh, herë më katranos!
Herë më ngren, herë më plandos!
Herë më pastron, herë më përdhos!
Herë më shpëton, herë më viktimos!
Herë më nderon, herë më marros!
Herë më shëron, herë më plagos!
Herë më ngazëllen, herë më brengos!
Herë më zgjidh, herë më prangos!
Herë më don, herë më muros!
Herë më errëson, herë më ndrit!
Herë më krenon, herë më zvarrit!
Herë më vesh, herë më zhvesh!
Herë më qesh, herë më ngërdhesh!

Herë më zbut, herë më egërson!
Herë më shtang, herë më shliron!
Herë më qetëson, herë më zemëron!
Herë më nxin, herë më vezullon!
Herë më trimëron, herë më frikëson!
Herë më përplas, herë më ngushllon!
Herë më përbuz, herë më ledhaton!
Herë më fal, herë më gjykon!
Herë më lidh, herë më çliron!
Herë më mbyt, herë më shpëton!
Herë më çmend, herë më kthjellon!
Herë më plak, herë më rinon!

Herë më fik, herë më ndez!
Herë më ftoh, herë më mërdhez!
Herë më djeg, herë më përflak!
Herë më përkdhel, herë më përgjak!

Herë më përlot, herë më gëzon!
Herë më kërrus, herë më lartëson!
Herë më shanë, herë më lavdëron!
Herë më vret, herë më gjallëron!

Herë e butë, herë e ashpër!
Herë si pëllumb, herë si gjarpër!
Herë e bukur, herë e shëmtuar!
Herë si nuse, herë e shtriguar!
Herë e dashur, herë e urryer!
Herë bujare, herë e ndërkryer!
Herë si lule, herë si therrë!
Herë si dritë, herë si terr!
Herë në qiell, herë në tokë!
Herë kam mend, herë s'kam kokë!

Herë besoj, herë dyshoj!
Herë pesimist, herë shpresoj!
Herë dorëzohem, herë qëndroj!
Herë di shumë, herë gjë s'kuptoj!
Kjo është Jeta që jetoj
Kjo është Rruga që rrugëtoj
Me vetëdije, pavetëdije
Është dhuratë Perëndie
Nuk i ngjanë moti-motit
Jeta ime – vullnet i Zotit.

NUK MJAFTON!

Nuk mjafton të quhesh Shqiptar
Kur armikut s'i del përballë!

Nuk mjafton të jesh idealist
Nëse nuk je nacionalist!

Nuk mjafton të thuash jam atdhetar
Kur nuk je çlirimtar!

Nuk mjafton të jesh patriot
Nëse Atdheut s'i del zot!

Nuk mjafton të quhesh luftëtar
Kur nuk ngjesh pushkë e jataganë!

Nuk mjafton të quhesh vizionar
Nëse s'ke ide, je trutharë!

Nuk mjafton të vetëquhesh komandant
Kur je mendjemadh e arrogant!

Nuk mjafton vetes t'i thuash udhëheqës
Nëse s'ke karizmë e s'je tërheqës!

Nuk mjafton veten ta emrosh lider
Kur ndaj shokëve po vjellë vrer!

Nuk mjafton të quhesh zëdhënës
Nëse s'je prof, por je nxënës!

Nuk mjafton të premtosh
Kur duar e kokë i ke bosh!

Nuk mjafton n'agim të mburresh
Dhe pasdite të përçurresh!

Nuk mjafton të fërfëllosh si furtunë
Dhe pastaj t'ia fusësh gjumë!

Nuk mjafton agjitacioni
Që të shpërthejë revolucioni!

Nuk mjafton as interneti
Që të mashtrohet sërish mileti!

Nuk mjafton radio-televizioni
Që të manipulohet opinioni!

Nuk mjafton komunikata
As gazeta, as deklarata!

Populli don punë, fakte...
Atdheu don çlirim, akte...

Këto troje ilirike
Kërkojnë Shqipëri Etnike.

USKANA

Po rrezon Dielli
Po shndrit Hana
Fortesë ilire
Qyteti Uskana.

Liri e dritë kudo mbolle
Shekujve u përballove
Mijëvjeçarët i përcolle
Lis në këmbë ti qëndrove.

Në çdo dru, në çdo gur
Ke gjurmë antike të Ilirit
Në çdo shteg e në çdo mur
Ke gjak lirie të Shqiptarit.

Linde lule, kështjellë Uskanë
Në furtuna e n'tramundanë
Kërçovë shqiptare ti rilinde
Armiqve kurrë nuk ju binde.

Në çdo kullë, në çdo portë
Ke themele, çelik të fortë
Dje këtu ishe, je sot dhe mot
E larë me gjak e njomur me lot.

Oj ilirja jonë Uskanë!
Më e bukura je ti Zanë.
Oj shqiptarja jonë Kërçovë!
Gjithë Shqipëria të ka Zonjë.

GJYSMË!

Gjysmë jemi,
Gjysmë kemi!

Gjysmë lufte zhvilluam,
Gjysmë lirie fituam!

Gjysmë ideali kemi!
Gjysmë të çliruar jemi!

Përgjysmë na ndanë!
Të gjymtuar na lanë!

Si mbollëm, ashtu korrëm,
Greko-sllavin nuk e shporrëm!

Sot Shqipëria copa-copa,
S'ka faj Bota, as Europa.

RRUDHAT...!

Rrudhat në ballë!
Si do ja bëjmë vallë?!
Rrudhat në fytyrë!
Ç'është kjo mynxyrë?!
Rrudhat në trup!
Bukuria na humb!

Rrudhat në zemër!
Fol drejt e rri shtrembër!
Rrudhat në tru!
Logjika tuj fluturu!
Rrudhat në shpirt!
Në terr pa dritë!

Shqiptar i rrudhur!
Shqipëri e ndrydhur!
Shqiptar i shtrydhur!
Shqipëri e tkurrur!

Rrudhat e Shqiptarit
Rrudha të jetës, të fatit.
Rrudhat e Shqipërisë
Rrudha të robërisë!

Rrudhat në trup të Shqiptarit
Rrudha të pleqërisë e të hallit.
Rrudhat e kufinjve të Shqipërisë!
Rrudha të përgjakura të historisë!

Rrudhosur Shqiptari!
Rrudhosur ideali!
Rrudhosur trimëria!
Rrudhosur Shqipëria!

I shohim e dot s'i ndalim!
Rrudhat e ballit, të pjekurisë.
I shohim e s'i flakim!
Rrudhat e Trojeve të Shqipërisë!

KRYENGRITËSI

(Ismajl Haradinajt)

Kryengritës që ngriti krye,
heshtje e pranga ka shpërthye.

Kryengritës që kokën nuk e uli,
"miku", as armiku s'e përkuli.

Kryengritës që pushtimit i tha: JO!
moto jete pat: "Vdis ose Fito!".

Kryengritës që kokën mbajti lartë,
s'e mposhtën burgjet, as grilat e zjarrtë.

Kryengritës që s'duroi nënshtrimin,
që gjer në vdekje mbajti BETIMIN.

Kryengritës stoik e vizionar,
luftëtar i Bashkimit Kombëtar.

Kryengritës me gjak të Dardanit,
Smajl Haradinaj i Gllogjanit.

Kryengritës i rracës pellazgjike,
trim, kreshnik i Shqipërisë Etnike.

Kryengritës që mbeti lapidar
zemra e sytë i nxirrnin strallë.

Kryengritës dhe Mësues,
Flamurtar e udhërrëfyes.

Kryengritës për Liri,
Kryengritës në përjetësi.

Suedi, 5 maj 2009

KOHË E PA KOHË!

I kam mbyllur të dy sytë,
s'shoh dot gjak ditë-përditë!

I kam mbyllur këta dy veshë
s'dëgjoj njerëz tuj u zgërdheshë!

E kam mbyllur gojën time
kush s'dëgjon këshilla, as udhëzime!

E kam mbyllur mendjen time,
s'kam ide për mashtrime!

I kam mbyllur tërë shqisat,
janë shkul lisat, janë nxirë plisat!

I kam ndrydhur gjitha ndjenjat,
s'këndojnë zogjtë, as mëllenjat!

Pres kohë tjetër për të parë,
pa viktima e të vrarë.

Pres kohë tjetër për të dëgjuar,
këngë lirie për të kënduar.
Pres kohë tjetër për të folur,
të tregoj se çka ka ndodhur.
Pres kohë tjetër për t'menduar,
kur arsyeja të ketë fituar.
Pres kohë tjetër për të shqisuar,
ëmbëlsira jete për të shijuar.
Pres kohë tjetër për të ndier,
kur helm e sheqer s'janë të përzier.

Sot nuk shoh, as nuk flas,
po don zemra të më plas!
Sot s'dëgjoj, mendja s'punon,
i gjithë trupi po m'lëshon!

Kohë e pa kohë, është koha jonë,
më dhemb koka, shpirti i shkretë!
Haj medet, kështu gjithmonë,
qe dhe mbeti kjo Planetë!

KEMI NJË..., KEMI SHUMË...

Kemi një Besë,
Kemi shumë shpresë.

Kemi një Flamurshqiponjë,
Kemi shumë dëshmorë-heronjë.

Kemi një Gjuhë-antikë,
Kemi shumë kreshnikë.

Kemi një gjak e një farë,
Kemi shumë luftëtarë.

Kemi një kombësi,
Kemi shumë urtësi.

Kemi një histori,
Kemi shumë trimëri.

Kemi një alfabet-peri,
Kemi shumë dituri.

Kemi një betim,
Kemi shumë përkushtim.

Kemi një ideal,
Kemi shumë flamurtarë.

Kemi një Atdhe,
Kemi shumë Skënderbe.

Kemi një Shqipëri,
Kemi shumë ardhmëri.

Kemi një, kemi shumë…,
Gurgullojnë si krua, rrjedhin si lumë…

KOHËT E JETËS

E kaluara është vajtim
Ardhmëria - supozim
E tashmja është realitet
Është jeta e vërtetë.

E kaluara nuk kthehet prapë
Ardhmëria ende s'ka ardhë
Vetëm e tashmja ekziston
Lum kush e di dhe e pranon.

E kaluara është e vdekur
E ardhmja ende s'ka lindur
E tashmja është e gjallë
Na shkruan në ballë.

Kujto të kaluarën pa mallëngjim
Jeto të tashmen me nderim
Mendo të ardhmen pa shqetësim
Dje, sot, nesër... - në udhëtim...
Zinxhirë jete pa mbarim...

E kaluara është kujtesë
E tashmja është jetesë
E ardhmja është shpresë
Që të tria bëjnë Fortesë.

Kohët e Jetës vijnë e ikin me rend
Njëra-tjetrës i lëshojnë vend
E kaluara, e tashmja e ardhmëria
Janë kohët e jetës, janë Përjetësia.

Kështu nisi, kështu vazhdon
Kështu filloi, kështu përfundon
Kështu vepron Gjithësia
Kështu don Zoti, Perëndia.

KY SHQIPTARI...

Le të tundet Shkup e Shkodër!
Le t'rrafshohet mal e kodër!
Le t'përmbyset Tokë e Qiell!
Le t'errësohet Hënë e Diell!

Le t'përzihet lum e det!
Ky Shqiptari e ka adet,
Nga një luftë me ba çdo vjet,
Nuk duron as kral, as mbret.

Si Shqiponja kur zbret malit,
Zjarr po marrin gurët e strallit,
Flakë po nxjerrin potkojt e kalit,
Godet armikun në lule të ballit.

Ky Shqiptari – pellazgian,
Ky Shqiptari – ilirian,
Ky Shqiptari – arbëror,
Ky Shqiptari - shqiponjë.

ZARET U HODHËN

Zaret vetë i hodhëm
Zaret vetë i mblodhëm!
Zaret i hodhëm, lufta filloi
Zaret i mblodhëm, lufta mbaroi!

Zaret u hodhën
Por asgjë nuk dolën!
Liri nuk na sollën!
Kufinj të ri mbollën!

Zaret u hodhën disa herë
Por s'fituam asnjëherë!
Se Rubikoni nuk u kalua!
Se liria nuk u fitua!
Se Atdheu nuk u çlirua!
Se Shqipëria nuk u bashkua!

Zaret u hodhën, por mungoi guximi!
Zaret u hodhën, por mungoi vendimi!
Zaret u hodhën, por mungoi bashkimi!
Zaret u hodhën, por mbet zhgënjimi!
Zaret u hodhën, por s'na u hoq zarari!
Se Shqiptarëve u mungoi Cezari!

SA SHUMË USHTRI!

Ca thonë janë tri,
Ca thonë s'ka asnji!
Ca thonë jemi Ne,
Ca të tjerë: “Ja ku na ke”!

Armiqtë hedhin valle,
Pushtetarët pijnë cigare,
Kush s'çanë kokën fare,
Për këto "ushtri" çlirimtare!

Sot i kemi tri "ushtri",
Nesër dhjetë me siguri,
Se shqiptari kështu e ka,
Një "ushtri" në çdo kazá!

Një komandant në çdo mëhallë,
Pak ushtarë, sa për farë,
Asnjë luftëtar për luftim,
Asnjë shqiptar për bashkim!

Sa shumë "ushtri",
Etnikja Shqipëri!
Sa shumë "ushtri" pa ushtarë,
Sa shumë "ushtri" me llafazanë!

Sa shumë "ushtri",
Sa pak liri!
Sa shumë copëtim e robëri,
Moj e dashura, e mjera Shqipëri!

S'KAM KOHË

S'kam kohë të lakmoj,
më duhet të lexoj.

S'kam kohë të bëlbëzoj,
më duhet të mësoj.

S'kam kohë të përgojoj,
më duhet të mendoj.

S'kam kohë të vendnumroj,
më duhet të hapëroj.

S'kam kohë të ngadalësoj,
më duhet të vrapoj.

S'kam kohë të harxhoj,
më duhet të punoj.

S'kam kohë të errësoj,
më duhet të xixëlloj.

S'kam kohë të mallkoj,
më duhet të bekoj.

S'kam kohë të armiqësoj,
më duhet të pajtoj.

S’kam kohë të vajtoj,
më duhet të këndoj.

S’kam kohë të lotoj,
më duhet të jetoj.

S’kam kohë për prapsi,
Kam kohë për mirësi.

S’kam kohë për ligësi,
Kam kohë për njerëzi.

NËNAT TONA

Nënat tona shamibardha,
shpirtbardha e pulëbardha.
Nënat tona shamikuqe,
zemërzjarrta e lulëkuqe.
Nënat tona lulëbozhure,
herë me djepa, herë me kobure.

Nënat tona - zana mali,
Nënat tona - xixa stralli,
Nënat tona - trimëresha,
Nënat tona - burrëresha.

Nënat tona dëbuan Turqinë,
Nënat tona mundën Greqinë,
Nënat tona rrënuan Jugosllavinë,
Nënat tona mposhtën Serbinë,
Nënat tona vullkan, tërmet e dridhje,
Pak me pushkë, më shumë me lindje.

Nënat tona lindën djem Ilirie,
lindën vasha Arbërie,
lindën shqiponja Shqipërie,
lindën Zeusë e Promethe,
lindën Pirro e Ante,
lindën Lekë e Skënderbe,
lindën Teuta e Adema…,
Nënat tona me shtatë zemra.

Shterroi kroi, lumi e deti,
Në vatrat tona përkundet djepi,
Nënat tona lindin dragonj,
Nënat tona rrisin heronj.

O NJERI!

O Njeri, o Njerëz!
O motra, o vëllezër!
A dini kush jeni?!
A dini nga vini?!
A dini pse jetoni?!
A dini ku shkoni?!

O Njeri, ti mend s'u mbushe!
Kurrë s'u gdhende, kurrë s'u zbute!
Egërsirë linde, egërsirë mbete!
Si në paqë, si n'tërmete!

Mos vra veten për çdo ditë!
Lëshoje terrin, dil në dritë!
Se kjo botë s'është e jotja!
Janë në ty jeta e mortja!

O Njeri pa logjikë!
Nga vetvetja ti ke frikë!
O Njeri pa vetëdije!
Mendja jote fije-fije!
O Njeri pa ndërgjegje!
Kurrë nuk fole, s'mu përgjegje!

O Njeri, ndal urrejtjen e racizmin!
Ndal vëllavrasjen e fashizmin!
O Njeri, ndal grykësinë e mashtrimin!
Ndali luftërat e shfrytëzimin!

O Njeri, flake xhelozinë dhe egoizmin!
Flake padijen e primitivizmin!
O Njeri, largo veset, vuajtjet, paudhësinë!...
Përqafo të vërtetën, gëzimin e drejtsinë!

O Njeri me shpirt hyjnie!
S'i del zot kësaj dhuntie!
O Njeri, krijesë hyjnore!
Mos shkatërro ç'të bjen përdore!

O Njeri, ke përgjegjësi!
S'je i vetmi në Gjithësi!
O Njeri, pa njerëzi!
Për çdo ditë zi e më zi!
O Njeri, që s'je Njeri!
Zbute zemrën, shpirtin përtri!
O Njeri, bëhu NJERI!
Si t'krijoi ZOTI Ty!

MOS...!

Mos mendoni se humbi Shqipëria
Mos thoni se vdiq trimëria
Mos besoni se s'ka bashkim kombëtar
Mos kujtoni se s'ka më luftëtarë.

Mos shpresoni, por punoni!
Mos pritni, por luftoni!
Mos luteni, por veproni!
Mos flini, mos ëndërroni!

Mos duro, mos u bë qyq!
Mos Shqiptar, mos rri duarkryq!
Se liria nuk vjen vetë,
Po e presim mbi dymijëvjetë!

NDREQ E PRISH!

Ndërto ditën, natën prish!
Vëllau – vëllanë e gërvish!

Shkatërro të huajtë, prish shqiptarët!
Fillo vendasit, mbaro barbarët!

Ndreq e prish, prish e ndreq!
S'na bjen në fije Zot, as dreq!

Ndreq e prish, shekuj me rradhë!
Prish e ndreq, ndër mijëvjeçarë!

Herë kolor, herë bardhë e zi!
Janë Shqiptarët me Shqipëri!

BUZËQESHJA E NGRIRË

Nuk mundem të këndoj!
Nuk mundem të vallëzoj!
Nuk mundem të gëzohem!
Nuk mundem të lumturohem!

Nuk mundem të qesh!
Në këtë lëmsh e përshesh!
Kur bota është në terr!
Nga të shoh vetëm tmerr!

Buzëqeshja m'është ngrirë
Trupi më është mpirë
Zemra më qanë
Shpirti më ofshanë
Mendja më fluturon
Loti më pikon
Këmbët më janë prerë
Goja më nxjerrë vrerë.

Buzëqesh në shtëpi
Buzëqesh me shokët e mi
Sapo dal në rrugë, në qytet
Buzëqeshja ngrinë, realiteti vret.

Gjak e luftëra rend e pa rend!
Varfëri e ferr në çdo kontinent!
Vuajtje, mjerim, padrejtësi, uri…
Buzëqeshjen ma kanë ngri.

MIJËVJEÇARËVE GJAK U DHAMË

Marr një laps e marr një letër
T'i këndoj historisë vjetër,
Të thurrë vargje, poezi
Për heronj e për Shqipëri.

Qysh kur ajri u bë frymë
Edhe fryma shpirtë e jetë,
Qysh kur Zoti krijoi Adamin
Kur s'kish rroba, veç një fletë,
Kur Errësira u bë Dritë
Rron Shqiptari n'Atlantidë.

Ramë nga Qielli
Mbimë nga Dheu
Na rriti Dielli
Na forcoi Atdheu.

Nga Qielli në Tokë
Nga Toka në Qiell
Zotër në Shqipëri
Porsi Hënë e Diell.

Dhjetëmijë vjet Pellazgji
Pesmijë vjet Iliri
Dymijë vjet Arbëri
Njëqind vjet Shqipëri
E përjetshme në Gjithësi.

Luftë pas lufte nëpër vite
Nëpër shekuj u kalite
Asnjëherë s'u përpëlite
Me armiq u kacafyte
Plagët kurrë s'u përthanë
Mijëvjeçarëve gjak u dhamë.

O HAJ, MEDET!

(Elegji)

Janë nxirë plisat,
o haj, medet!
Janë tharë lisat,
o haj, medet!

Janë rrafshuar kullat,
o haj, medet!
Janë frikësuar burrat,
o haj, medet!

Janë shuar votrat,
o haj, medet!
Janë zezuar motrat,
o haj, medet!

Janë shkulur plepat,
o haj, medet!
Janë përmbysur djepat,
o haj, medet!

Janë fikur kandilat,
o haj, medet!
Janë trembur bilbilat,
o haj, medet!

Janë vyshkur lulet,
o haj, medet!
Janë shqyer daullet,
o haj, medet!

Janë ndryshkur hutat,
o haj medet!
Janë flakur lahutat,
o haj, medet!

Janë ndalur trimat,
o haj, medet!
Janë shtuar jetimat,
o haj, medet!

Janë shkarkuar rrufetë,
o haj, medet!
Janë gozhduar promethetë,
o haj, medet!

Janë braktisur idealet,
o haj, medet!
Janë përkulur malet,
o haj, medet!

Janë rrëzuar muret,
o haj, medet!
Janë ndërruar Flamurët,
o haj, medet!

Janë ngritur kufinjtë,
o haj, medet!
Janë shtuar gjarpërinjtë,
o haj, medet!

Janë copëtuar Trojet,
o haj, medet!
Janë shterrur krojet,
o haj, medet!

Janë trazuar Tokë e Qiell,
o haj, medet!
Janë errësuar Hënë e Diell,
o haj, medet!

Janë përçarë Shqiptarët,
o haj, medet!
Janë fituesë barbarët,
o haj, medet!

NE DHE KOHA

Lindim në kohë,
Rritemi në kohë,
Plakemi në kohë,
E mbijetojmë kohën.

Rrëzohemi në kohë,
Ngritemi në kohë,
Na shkelë koha,
E mundim kohën.

Nisemi në kohë,
Vrapojmë në kohë,
Vonohemi në kohë,
E arrijmë kohën.

Luftojmë në kohë,
Humbim në kohë,
Fitojmë në kohë,
E mposhtim kohën.

Ecëm në kohë,
Ecim në kohë,
Ecim me kohën.

Jetuam në kohë,
Jetojmë në kohë,
Jetojmë me kohën.

Herë koha, herë Ne,
Herë me Liri, herë pa Atdhe,
Herë humbës, herë fitimtarë,
Koha dhe Ne - të pandarë.

KY SHEKULLI I RI

Ky Shekulli i Ri,
është një shekull tjetër,
por me shumë prapësi,
sikur Shekulli i Vjetër!

Ky Shekulli i Ri,
me moshën 8-vjeç,
i moçëm për dredhi,
tekanjoz e kryeneç!

Ky Shekulli i Ri,
i ri porsi fëmi,
mbrapsht ia filloi,
si shekulli që shkoi!

Ky Shekulli i Ri,
erdhi me shumë premtime,
për paqë dhe liri,
por solli veç mjerime!

Ky Shekulli i Ri,
është një vazhdimësi,
e shekullit plak,
mbushur luftëra e gjak!

Ky Shekulli i Ri,
ky shekull i zi,
jetën po na nxi,
me këto padrejtësi!

Ky Shekulli i Ri,
shekull me ligësi,
me plagë të vjetra ngeli,
plagë të reja çeli!

Ky Shekulli i Ri,
me emër Njëzetenji,
gjë të mirë nuk solli,
për këtë Njerëzi!

SHQIPTARË!

Shqiptarë!
Njëri-tjetrin rrespektoni!
Për bashkim e për liri
Mos pritni, po veproni!
Se durimi ka kufi.

Shqiptarë!
Delni n'fushë e n'mejdan
Ngjituni malit përpjetë
Me flamur e jatagan
Se liria nuk vjen vetë.

Shqiptarë!
Mbani vesh dhe dëgjoni!
Kur Kushtrimi të jehojë
Rrokni armët dhe luftoni!
Shqipëria të bëhet Zojë.

KËRKOJ…

Me kandil në dorë,
kërkoj Rrugën, Vërtetësinë.

Me pushkë e shpatë,
kërkoj Lirinë.

Me laps e penë,
kërkoj Drejtësinë.

Me libër e ligj,
kërkoj Barazinë.

Me lutje njerëzore,
kërkoj Paqën, Harmoninë.

Me Llampën e Diogjenit,
kërkoj Njerinë.

Kërkoj pandërprerje,
Mirëkuptim e mirësi,
Sa shumë mizerje,
Vetëm pak njerëzi!

Me pishë e qiri,
Kërkoj dritë, lumturi,
E mira përfundi,
E keqja përmbi!

Kërkoj, kërkoj, …
Ngado që shkoj,
Në tokë vigjëloj,
Mbi valë po notoj,
Mbi re fluturoj,
Kërkoj, kërkoj, …

Kërkoj në Tokë, kërkoj në Qiell,
Natën me Hënë, ditën me Diell,
Kërkoj, kërkoj, kërkoj, …
Ngado që endem, ngado që shkoj.

ÇAMËRI, IKONË KOMBËTARE!

Çamëri na dogji malli,
Sytë na nxjerrin xixa stralli.

Sytë lot na lotojnë,
Zemrat gjak na gjakojnë.

Vjen një zë nga Janina,
Zgjohi vëllezër, bini trima!

Bubullinë, gjëmon Preveza,
Flakadanët thotë i ndeza!

Flamurkuqin ngre Konica,
Pas i shkon dhe Gumenica.

S'mbetet prapa as Filati,
Tani thotë ka ardhë sahati.

Shqipe mali e zemër burri,
Parga trime dhe Kosturi.

Sikur Marko, Foto e Bubulina,
Qëndron Arta e Florina.

Thonë s'durohet më Greqia,
Margëlliçi e Paramithia.

Çamëria në këmbë është ngritë,
Po kërkon diell e dritë.

Mbarë Çamëria po betohet,
Me Shqipërinë të bashkohet.

Ti je motra e Mollosisë,
Je pasardhëse e Thesprotisë.

Ti je bija e Ilirisë,
Shtojzovalle e Shqipërisë.

Çamëri, ikonë kombëtare,
Tokë e Shenjtë Shqiptare.

ATDHEU DHE UNË

Mendja jote - mendja ime,
Gjykojnë drejt, pa gabime.

Zemra jote - zemra ime,
Rrahin fortë me ngazëllime.

Besa jote - Besa ime,
Rreze drite me vezullime.

Qëndresa jote - qëndresa ime,
Bashkë e tok në luftime.

Pena jote - pena ime,
Shkruajnë shqip me ligjërime.

Shpata jote - shpata ime,
Janë dy skaje të një vetëtime.

Syri yt - syri im,
Ditë e natë në vigjëlim.

Zëri yt – zëri im,
Bubullimë dhe kushtrim.

Betimi yt – betimi im,
Krah për krah në marshim.

Vullneti yt - vullneti im,
Të pandarë në amshim.

Fati yt – fati im,
Herë i ëmbël, herë pelim.

Ëndrra ime - ëndrra jote,
Vizion i një epoke.

Lufta ime - lufta jote,
Ardhmëria e kësaj toke.

Rruga jote - rruga ime,
Rrugë e gjatë, plot shtegtime.

Fitorja jote - fitorja ime,
Këngë e valle, shumë gëzime.

Liria jote - liria ime,
Lule e bukur plot shkëlqime.

Jeta jote - jeta ime,
Histori me shumë flijime.

Unë dhe Atdheu:
Sikur Leka e Anteu,
Sikur Pirro e Prometheu,
Si Bardhylli e Skënderbeu.

Unë dhe Ti jemi Nji,
Ti i Shenjtë, unë Njeri,
Jemi bashkë në përjetësi,
Unë Shqiptar, Ti Shqipëri.

FLAMURI I GJAKUT

Të gjuajnë "Zeusët" me rrufé
Me të zhdukë nga ky Dhé
Ti qëndron si Anté
Ti lufton si Skënderbé
I pamposhtur - Promethé.

Ti valon i kuq - krenar
Në çdo vatër, në çdo prag
Në çdo kullë, në çdo shtëpi
Në çdo zemër në Shqipëri.

Flamur i lindur nga gjaku
Flamur i fituar me gjak
Flamur i mbrojtur me gjak
Flamur që kullon gjak.

Të rënët e gjallë
Do ngriten nga varri
Flamurin me Shkabë
T'a shpëtojnë nga barbari!

Do të luftojnë
Me shpatë e hekur
Se nuk e mbrojnë
Të gjallët e vdekur!

DISA DITË...

(Monologu i Shqiptarit)

Disa ditë më shkëlqejnë sytë
Trupin ma përshkon një dritë.

Disa ditë më ndalet fryma
Shpirtin tim e mbulon bryma!

Disa ditë më rreh zemra,
Gufon gjaku nga koka te thembra.

Disa ditë më ngrinë gjaku
Këmbëkryq armiqtë ulur te pragu!

Disa ditë këndoj me gëzim,
Kur shoh Shqipet n'fluturim.

Disa ditë lotoj nga tmerri,
Kur Atdheun e zen terri!

Disa ditë jam trim me fletë,
Disa ditë frikacak i vërtetë!

Disa ditë jam bardhan,
Disa ditë i zi, katran!

Disa ditë jamë i mirë, meleq,
Disa ditë i keq, për dreq!

Disa ditë jam altruist,
Disa ditë egoist!

Disa ditë jam gjuhëshpatë,
Disa ditë gojëthatë!

Disa ditë jam kolos,
Disa ditë përtokë plandos!

Disa ditë jam kumri,
Disa ditë gjarpër i zi!

Disa ditë jam plis,
Disa ditë i pafis!

Disa ditë jam kreshnik,
Disa ditë ia mbath, ik!

Disa ditë jam militant,
Disa ditë pa nagant!

Disa ditë jam patriot,
Disa ditë idiot!

Disa ditë jam tribun,
Disa ditë majmun!

Disa ditë jam mendimtar,
Disa ditë gomar!

Disa ditë jam dëshmor,
Disa ditë tradhtor!

Disa ditë jam liberator,
Disa ditë puthadorë!

Disa ditë jam stoik,
Disa ditë apatik!

Disa ditë jam uragan,
Disa ditë mjeran!

Disa ditë jam optimist,
Disa ditë pesimist!

Disa ditë jam Shqiptar,
Disa ditë Njeri, planetar!

SA SHUMË..., SA PAK...!

Sa shumë kemi ëndërruar,
sa pak kemi realizuar!

Sa shumë kemi punuar,
sa pak kemi ndërtuar!

Sa shumë kemi hequr,
sa pak kemi ndrequr!

Sa shumë kemi sakrifikuar,
sa pak jemi ngushëlluar!

Sa shumë pranga e zinxhirë,
sa pak shqiptarë të lirë!

Sa shumë varrë e plagë,
sa pak trima e luftëtarë!

Sa shumë kemi luftuar,
sa pak kemi fituar!

Sa shumë jemi vrarë,
me shekuj e mijëvjeçarë!

Sa shumë pushtim,
sa pak çlirim!

Sa shumë robëri,
sa pak liri!

Sa shumë kemi pritur,
sa pak jemi rritur!

Sa shumë është derdhur gjak,
Shtet e Liri - sa pak, sa pak!

FJALA

E para qe Fjala,
Fjala - si vala.

Fjala e ëmbël të shëron,
Fjala e idhët të helmon.

Fjala e lehtë – vullnet,
Fjala e rëndë të vret,

Fjala e mirë – shëndet,
Fjala e keqe të tret.

Fjala e gëzueshme të ndrit,
Fjala e kobshme të lebetit.

Fjala - më e butë se pëllumbi,
Fjala - më e fortë se plumbi.

Fjala - të ngroh zemër e kokë,
Fjala - të fut nën tokë.

Fjala - të ngren në këmbë,
Fjala - të thyen duar e dhëmbë.

Fjala - shpëton atdhe,
Fjala - të rrëzon përdhe.

Fjala lëviz male,
Fjala largon halle.

Fjala trazon dete,
Fjala sjellë tërmete.

Fjala ndez kryengritje
Fjala shuan etje.

Fjala jep kushtrim,
Fjala shpallë çlirim.

Fjala bashkon trojet,
Fjala shterron krojet.

Fjala është për trimat,
Fjala shkrep vetëtimat.

Fjala është për burrat,
Fjala freskon gurrat.

Fjala është Besë,
Fjala është shpresë.

Fjala është Betim,
Fjala është besim.

Fjala është fillimi,
Fjala është mbarimi.

JEMI BËRË...

Jemi bërë vetëtimë e rrufé,
për Atdhe.
Jemi bërë Promethé,
për Atdhe.
Jemi bërë Anté,
për Atdhe.
Jemi bërë Skënderbe,
për Atdhe.
Jemi bërë Diell me nxe,
për Atdhe.
Jemi bërë Hënë e Re,
për Atdhe.
Jemi bërë gjak-rrëke,
për Atdhe.
Jemi bërë lisa deri në re,
për Atdhe.
Jemi bërë dhé,
për Atdhe.

Jemi bërë shkrumb e hi,
për Shqipëri.
Jemi bërë copa e kërdi,
për Shqipëri.
Jemi bërë gacë e shkëndi,
për Shqipëri.

Jemi bërë dallgë e stuhi,
për Shqipëri.
Jemi bërë trima pakufi,
për Shqipëri.
Jemi bërë nga pleq - të ri,
për Shqipëri.
Jemi bërë gjeneralë e gjeni,
për Shqipëri.
Jemi bërë lahutë e sharki,
për Shqipëri.
Jemi bërë këngë e rapsodi,
për Shqipëri.
Jemi bërë dramë e tragjedi,
për Shqipëri.
Jemi bërë themel e tapi,
për Shqipëri.

Jemi bërë heronj e liri,
për Atdhe e për Shqipëri.
Jemi bërë e s'jemi zhbërë,
jemi Ilirë - Një Komb i tërë.

NJERËZ-DJAJTË!

Luten ditën, vrasin natën!
Luten natën, vrasin ditën!
Luten për vete, vrasin tjetrin!
Nxijnë jetën, shuajnë dritën!

Janë bisha me pamje njeriu!
Disa falen, disa kryqohen!
Fytyrë djalli e dhëmbë ariu!
Nga njëri-tjetri nuk dallohen!

Thirren në fe, thirren n'Zot!
Janë të pabesë, pa karakter!
Janë pa zemër, në sy pa lot!
Ngado shkojnë mbjellin vrerë!

Janë gjarpërinj, janë hiena!
Herë helmojnë, herë kafshojnë!
Si virusët nëpër vena!
Njërëzdjajtë na shkatërrojnë!

RRI ZGJUAR...

Rri zgjuar në gjumë,
mendimet rrjedhin lumë.

Rri zgjuar në ëndërr,
herë luftëtar, herë dhëndërr.

Rri zgjuar natën e ditën,
përhap dijen, shpërndajë dritën.

Rri zgjuar mendja ime, zgjuar rri,
kandil në shekuj, gacë e shkëndi.

Rri zgjuar zemra ime, zgjuar rri
rreh për dashuri, këndon për liri.

Rri zgjuar shpirti im, zgjuar rri,
kërkon drejtësi, lutet për njerëzi.

Rri hapur syri im, hapur rri
vigjëlon, roje bën mbi Shqipëri.

Rri i zgjuar unë, zgjuar rri,
derisa Ballkani të bëhet Iliri.

QOFSH ME JETË,
KOSOVË DARDANE!

Jam Shqiptari nga Shqipëria
Që nga jugu në veri,
Të gjithë vëllezërit e njerëzia
Sy e mendje i kanë tek Ti.

Gjithë të mirat e mbarësi,
Uron Ilirida me dashamirësi,
Veç gëzime, aspak halle
Motër Kosova atdhetare.

Maje kepit, nga Malësia
T'përshëndet Plavë e Gucia,
Mbaje motër kokën lartë
Shqipëria do bëhet bashkë.

Atje poshtë buzë detit Jon
Çamëria po jehon,
Ballin lartë, veç përpara
Oj Kosovë, të prift e mbara!

Nga Presheva e Bujanoci
Nga Medvegja e Tërrnoci,
Kosova Lindore po t'uron
Bija jote po t'kujton.

Mërgimtarët nga diaspora
Thonë se lindi sërish Vlora,
Sot Kosova u bë Shtet
Nesër Shqipëria e vërtetë.

I gjithë Kombi po t'uron
Shqiptaria po feston,
Kosova-Shtet, u bë e lirë
E pavarur, pa zinxhirë.

Qofsh me jetë,
Kosovë dardane!
Rofsh e qofsh Ti përjetë,
Oj Kosovë pellazgiane!

17 Shkurt 2008

LULJA DHE PRANVERA

Populli thotë nga brezi në brez:
”Dita e mirë shihet në mëngjez”,
kur lind dielli me rreze ari,
kur çel lulja e rritet bari.

Shumë politikanë e liderë,
s’duan diell, dritë,… as verë!
Dhe po bëjnë njëmijë mynxyra,
të mbulojnë fytyrat e pafytyra!

“Me një lule nuk vjen pranvera”!
Ende lulja s’ka çelë te dera!
S’ka ardhë pranvera, as liria!
S’është bashkuar Shqipëria!

”Qeni që leh nuk të kafshon”!
Politikani veç të mashtron!
Ka ndal liri dhe pranvera!
Lulet i ka shndërruar në therra!

SOT...

Sot po më dridhet maja e penës,
Po më gufon gjaku i zemrës!
Sot po më dridhen leqet e këmbës,
Po më shterron zëri i këngës!

Sot Kosova – Republikë,
Po më kaplon një e madhe frikë!
Sot u shpallë Pavarësia,
Po nuk është sikur Shqipëria!

Sot u shpallë Kushtetuta,
Por mu duk zi si futa!
Sot ajo doli nga sirtari
Po aty nuk është Shqiptari!

Nëpër oda e nëpër ndeja
Bisedohet për kohët e reja,
Si në radio, në televizion
Flitet shumë për këtë vizion,
Në Kuvend, nëpër gazeta
Duhet thënë veç e vërteta:

Kjo Kosova Shtet u shpallë,
Po shqiptarë a mbetëm, vallë?!
Kjo Kosova me Flamur të ri,
A do mbetet Shqipëri?!

Kjo Kosova me Kosovarë,
Shumë qytetarë, pak shqiptarë!
Kjo Kosova me gegënishte t'vet,
Pa gjuhë letrare po don me mbet!
Kjo Kosova me Hymn pa tekst,
Veshët hapur, gojën memec!
Kjo Kosova me shtete në Shtet,
Plot enklava për ibret!

Sot Kosova është hava,
S'ka hyp në qiell, në tokë s'ka ra!
As dardane, as shqiptare,
Republikë ekperimentale!

Qershor, 2008

GJAKU DHE UJI

Gjaku nuk bëhet ujë,
Nuk bëhemi të hujë,
As uji gjak nuk bëhet,
Kosova nuk shpërbëhet.

Mendtë i kemi në kokë
Uji rrjedh në tokë,
Shqiptari s'bëhet "Kosovar",
Gjak shqiponje ka n'damarë.

Pesëmijëvjet kohë e gjatë
Pesëmijëvjet Kosovë dardane,
Nuk po zhbëhet për një natë
Nga politika mendjemadhe.

Pesëmijëvjet Shqiptar mbi dhe
Pesëmijëvjet – një At-Mëmëdhe,
Pesëmijëvjet Kosovë shqiptare
Nuk do të bëhet tjetërfare.

Gusht 2008

NË KËTË BOTË...

Në në këtë botë pa njerëzi,
është vështirë të jesh Njeri!

Në këtë botë pa drejtësi,
është vështirë të fitosh Liri!

Në këtë botë plot marrëzi,
shumë urrejtje, pak dashuri!

Në këtë botë plot me halle,
ujqër e qengja hedhin valle!

Në këtë botë përplot çudi,
gjysma bardhë, gjysma zi!

Në këtë botë plot ligësi,
lot e dhimbje pakufi!

Në këtë botë plot me klithma,
të therë zemra, të kap dridhma!

Në këtë botë plot shtrëngata,
të ngrinë bora e të djeg flaka!

Në këtë botë lakadredhë,
pushtetari dredhë e zhdredhë!

Në këtë botë me andralla,
pak t'vërteta, më shumë përralla!

Në këtë botë dallga-dallga,
këmbë e duar lidhë me pranga!

Në këtë botë thërrime-thërrime,
e mira me t'keqen shpinë për shpine!

Në këtë botë si cektinë,
jeta e vdekja këmbkryq rrinë!

Në këtë botë kasaphanë,
vret vëllau-vëllanë!

Në këtë botë të çakërdisur,
herë i mençur, herë i krisur!

Në këtë botë të gjakosur,
luftëtërat, vrasjet s'kanë të sosur!

Në këtë botë plot mallkime,
s'ndihmojnë lutje, as përgjërime!

Në këtë botë me psherëtima,
si xhelati, si viktima!

Në këtë botë me trauma,
të zihet fryma, të del shkuma!

Në këtë botë plot llahtari,
shumë tmerr e lemeri!

Në këtë botë me lakmi,
pak ngopje, shumë grykësi!

Në këtë botë plot dredhi,
shtatë hile, një trimëri!

Në këtë botë me trishtim,
pak gëzime, shumë hidhërim!

Në këtë botë ferr-skëterrë,
mbillesh lule, shpërthen therrë!

Në këtë botë si greminë,
njeriu përbin njerinë!

Në këtë botë përplot terror,
shumë djaj, pak shenjtorë!

Në këtë botë hallakamë,
mbushur shtriga e shtriganë!

Në këtë botë paradoksale,
liri, barazi,... - fjalë banale!

Në këtë botë iluzore,
pak fushë, shumë bregore!

Në këtë botë kaotike,
plot shpërthime vullkanike!

Në këtë botë dramatike,
shumë përleshje tragjike!

Në këtë botë plotë huti,
qarje - qeshje varg e vi!

Në këtë botë me xhelozi,
orë e çast një pabesi!

Në këtë botë me varfëri,
vjedhje, krim dhe uri!

Në këtë botë me rënkime,
pak këngë, shumë vajtime!

Në këtë botë lara-lara,
të qesh fati, të humb fara!

Në këtë botë vandaliste,
pak solidare, shumë egoiste!

Në këtë botë të tymosur,
blozë e hi – katranosur!

Në këtë botë fillim pa fillim,
vuajtjet, luftërat s'kanë mbarim!

Në këtë botë fund pa fund
e mira të keqen nuk e tund!

Në këtë botë, si n'atë botë,
mjaltë e helm në një gotë!

Në këtë botë, mbi këtë Tokë,
të dridhet zemra, t'luajnë mend në kokë!

Në këtë botë, në këtë Planetë,
bashkë: njerëz, engjuj, djaj e lanetë!

ZJARR ...
(Shqiptari)

Zjarr ndër vite dhe epoka,
Zjarr dhe flakë s'e mban toka.

Zjarr ndër shekuj e mijëvjaçarë,
Zjarr dhe tym trupi mbarë.

Zjarr në luftë e në paqë,
Zjarr dhe xixa t'uj përhapë.

Zjarr që ndizet për vatan,
Zjarr që ndritë si flakadan.

Zjarr që digjet për liri,
Zjarr që s'shuhet për Shqipëri.

Zjarr – rrufe, përvëlues,
Zjarr Shqiptari për sunduesë.

S'ËSHTË KOHA, ËSHTË KOHA

S'është koha e llafazanëve,
është koha e luftëtarëve.

S'është koha e beterëve,
është koha e maliherëve.

S'është koha e teorisë,
është koha e lirisë.

S'është koha e trutharëve,
është kohë e vizionarëve.

S'është koha e agonisë,
është koha e trimërisë.

S'është koha e frikamanëve,
është koha e guximtarëve.

S'është koha e dorëzimit.
është koha e dyluftimit.

S'është koha e biftekut,
është koha e dyfekut.
S'është koha e bibanit,
është koha e mejdanit.

S’është koha e durimit,
është koha e marshimit.

S’është koha e pazarit,
është koha e Adem Jasharit.

S’është koha e vajtimit,
është koha e betimit.

S’është koha e predikimit,
është koha e kushtrimit.

S’është koha e largimit,
është koha e bashkimit.

S’është koha e tradhtarëve,
është koha e atdhetarëve.

S’është koha e barbarëve,
është koha e Shqiptarëve.

S’është koha e Greko-Serbisë,
është koha e Shqipërisë.

PUNËT E ZOTIT

Po të mos ishte Perëndia,
S'do ish Jeta, as Gjithësia.

Po të mos ishte Zoti,
Toka ish zhduk qëmoti.

Atlantidën Zoti e fundosi,
Kur atë e mbuloi kaosi.

Nga Parajsa dëboi Adamin dhe Evën,
Shtëpi atyre ua bëri shpellën.

Filloi Njeriu që nga e para,
Të gjuaj, të vjeli,... të mbjelli ara.

Sot Njeriu ka shkuar në Hënë,
Po NJERI ende s'është bërë.

Nuk njeh Zotin, Perëndinë,
Lufton "Njeriu" me Njerinë.

Sërish Përmbytja është pas dere,
Vallë, si do t'ia bëjmë kësaj here?!

GJURMËT TONA

Gjurmët tona
si rrezja e dritës
janë të lashta
prej Atlantidës.

Janë gjurmë toke pellazgjike
Janë gjurmë gjuhe ilirike
Janë gjurmë luftërash arbërore
Gjurmë qëndrese burrërore.

Gjurmë në tokë
Gjurmë në kokë.

Gjurmë në gjak
Gjurmë në bajrak.

Gjurmë në zemër
Gjurmë në emër.

Gjurmë në beteja
Gjurmë në rrufeja.

Gjurmë në flakë
Gjurmë në plagë.

Gjurmë në barot
Gjurmë në lotë.

Gjurmë në varre
Gjurmë në valle.

Gjurmë në këngë
Gjurmë në gojëdhënë.

Gjurmë në veshje
Gjurmë në përleshje.

Gjurmë antike
Gjurmë fisnike.

Gjurmë fortese
Gjurmë bese.

Gjurmë lirie
Gjurmë trimërie.

Gjurmë legjendare
Gjurmët shqiptare.

Gjurmët tona të pavdekshme
Gjurmët tona të përjetshme
Gjurmët tona pambarim
Gjurmët tona në shtegtim
Si shqiponjat n'fluturim.

Gjurmët tona të thella
Në truallin arbëror
Mbi kulla e kështjella
Ndrisin meteorë.

SHQIPËRIA ETNIKE

Gurthemeli i Pellazgjisë,
është Krijesë e Perëndisë.
Panteoni i Perëndive,
është Vullneti i Hyjnive.
Embrion për Shqipërinë,
këtu Zeusi kish selinë.

Është Legjendë mitologjike,
është Baladë e lashtë kreshnike,
është Etni pellazgjike,
është Hyjneshë ilirike.

Është Tempulli i Dodonës,
Piedestali i Shqiponjës,
është Altari i Lirisë,
sot është Zemra e Ilirisë,
është Rilindja e Arbërisë.

Është si Dielli kur rrezon,
porsi Hëna kur ndriçon,
është Kështjellë gur mbi gur,
është Shqiponjë e Flamur,
është Feniks që nuk vdes kurrë.
Është burim e gurrë lirie,
është betim e gjoks rinie,
është Ylber e Yll Gjithësie,
është Kala - Themel Shqipërie.

Është prush që përvëlon,
është këmbanë që ushton,
është rrebesh që shkatërron,
ortek bore që mbulon,
është tërmet që tmerron.

Është si lulja plotë me erë,
dallëndyshe në pranverë,
është kullë brezash me bajrak fisi,
vatër arbërore me bardhësi plisi.

Është zjarr e vullkan,
është stuhi e uragan,
është furtunë e bubullimë,
është rrufe e vetëtimë,
është top e jatagan,
është princ e kapedan,…
që luftojnë për vatan.

Është gjaku ynë që nuk falet,
zemra jonë që nuk ndalet,
është si buka në çerep,
dhe si uji nën një kep,
është si ajri n'atmosferë,
është si drita në humnerë,
pa të cilat s'ka jetë as nderë.

Shqipëria Etnike është e gjallë,
si baroti e guri strallë,
është një rrënjë që s'shkulet fare,
ëndrra jonë mijëravjeçare,
është si nuse me kurorë lavdie,
Zanë e bukur Ilirie.

Kjo Shqipëria jonë Etnike,
është trimëreshë heroike,
që nuk njeh asnjë pushtet,
derisa të bëhet Shtet.

ME TY, POEZIA IME!

Me ty kalova fëmijërinë,
Me ty përjetova rininë,
Me ty arrita burrërinë,
Me ty mësova historinë,
Me ty pata shumë gëzime,
Me ty, Poezia ime!

Me ty nisa të krijoj,
Me ty nisa të vargëzoj,
Me ty u rrita në robëri,
Me ty këndova për liri,
Me ty u nisa në shtegtime,
Me ty, Poezia ime!

Me ty godita çdo armik,
Me ty kandili nuk u fik,
Me ty trokita prag më prag,
Me ty shërova varrë e plagë,
Me ty në dasma e n'flijime,
Me ty, Poezia ime!

Me ty pena nuk u tha,
Me ty kombi nuk u nda,
Me ty shpresa nuk u shua,
Me ty besa u forcua,
Me ty n'fitore e ngadhnjime,
Me ty, Poezia ime!

ZGJOHU, NGRITU SHQIPËRI!

Re të zeza të kanë mbuluar!
Diell e Hënë të kanë errësuar!
S'je në ëndërr!
Por je zhgëndërr!
Në terr të zi e n'robëri!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Laku n'fyt po t'shtrëngon!
Pranga trupin ta mundon!
Okupimi po t'shkatërron!
Armiqtë sulen me egërsi!
Me ushtri e me djallëzi!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Mjaft Ti fjete dhe u përgjume!
Mjaft Ti ndejte e ngujume!
Mjaft Ti prite ditë-përditë!
Hape terrin - bëhe dritë!
Ndize zjarrin nga një shkëndi!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Më dhemb zemra kur rënkon!
Kur nga dhembjet Ti gjëmon!
M'hapet goja e s'mund të flas!
Jap kushtrim e po bërtas!
Por askush nuk më dëgjon!
Por askush nuk më beson!
I gjithë trupi të është shkri!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Kam shumë zjarr e shumë dhimbje,
Kam shumë vuajtje e shumë dridhje,
Kam shumë mall e dashuri,
Kam shumë dhembje e krenari,
Kam shumë ankth e burrëri,
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Shpatë e Damokleut të rrin mbi kokë!
"Pako" e "Traktate" hartojnë me okë!
Rezoluta (1244) e 14 Pika!
Gjithësecila më e mprehtë se thika!
Trupin copa ta copëtojnë!
Shpirt e zemër të dërrmojnë!
Trojet Tua t'i pushtojnë!
Marimangat thurrin robëri!
Kameleonët endin tradhti!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Serbia jepë autonomi!
Bota jepë gjysmëpavarësi!
Ç'janë këto hile një dreq e di!
Gjithçka janë veç jo liri!
T'ka hy n'Kullë Bajlozi i Zi!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Janë ndryshkë armët mbi tavan!
Pastro shpatë e jatagan!
Dil në shesh dhe n'mejdan!
Shpërthe vrullshëm si vullkan!
Ja Vdekje – Ja Liri!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Mos i le armët të ndryshken!
Mos i le teshat të myken!
Mos e le luftën në mes!
Mos e le idealin t'vdesë!
Mos harro - je Iliri,!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Gjithë Kosova n're të zeza!
Nënat, motrat shamizeza!
Frynë stuhia e shfrynë era!
Lufta të troket te dera!
S'ka liri, s'ka pavarësi!
S'ka bashkim, as drejtësi!
Rroki armët përsëri!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

Zgjohu, ngritu - del te dera!
Se sërish po vjen pranvera.
Se liria s'vjen çdo ditë,
Ikë nga terri - del në dritë!
Del në dritë e n'liri!
Mos duro më tirani!
Sllavo-grekë, as dredhi!
Zgjohu, ngritu Shqipëri!

SHQIPËRIA DHE PROMETHEU

(Baladë)

Linde
në kohë të lashta
të tejlashta - Shqipëri!
Askush nuk e di kur e si linde Ti!
Mbive nga Dheu, nga Toka u krijua At-Dheu.

Linde
e para - Shqipëri!
me emrin e bukur Pellazgji
me vullnet e përsosmëri Zoti të krijoi
dhe fat, mbarësi, lavdi e udhë të mbarë të uroi.

U fundose
me emrin Atlantidë
por sërish dole në jetë, në dritë
linde Pellazgji, u rilinde Iliri, jetove Arbëri
mbijetove përjetësisht me emër Shqiponje - Shqipëri.

Prometheun
e lindi Pellazgjia
e rriti Iliria e burrëroi Arbëria
e lartësoi dhe e përjetësoi Shqipëria
që ndër shekuj e mijëvjeçarë të ndrisë si
shkëndia.

Nënë e bir
dorë për dorë e krah për krah
si dasmorë ecën nëpër histori, nëpër
lashtësi
nëpër tokë e qiell, nëpër yje e diell, nëpër
Gjithësi.

Në këmbë
duke ecur e vrapuar
herë shaluar, herë duke fluturuar,
gjithmon bashkë, përherë tok e të pandarë.

Nga parahistoria
deri në histori e ardhmëri
bashkë çanë përpara të pamposhtur
në rrugën e tyre të gjatë të jetës e të luftës
në tokën e të drejtën e vet, duke sfiduar
ballëlartë
armiqtë e tyre barbarë, nëpër shekuj dhe
mijëvjeçarë.

Legjendat
thonë se Prometheu
ua rrëmbeu "zjarrin" - lirinë
"Perëndive" të lashtë të Olimpit
sundimtarëve misterioz të Pellazgjisë
dhe ua dhuroi Pellazgëve, njerëzve –
popullit.

Prandaj
ata e zunë, e lidhën
e prangosën, e mbërthyen
dhe e gozhduan për një shkëmbi
sikurse më vonë romakët Krishtin në kryq.

E dënuan
me vdekje, interrnim
në cepin më të largët të Pellazgjisë
në veri të vendit, në malet shkëmbore të
Kaukazit.

"Perënditë"
nga Prometheu
frikësoheshin dhe për së vdekuri
kujtuan se e vranë, por nuk vritej liria
nuk gjunjëzohej populli, nuk ndalej
Pellazgjia
rilindi Promethe At-Mëmëdheu, si Herkuli e
Anteu.

Pellazgjia
Lindi, rriti dhe kaliti
Promethe në vazhdimësi
nga Leka i Madh e Pirro Epiroti
deri tek Bardhyli dhe Gjergj Kastrioti
nga Trimat e Jutbinës – Omeri, Muji e Halili
deri te Gjergj Elez Alia, Mic Sokoli, Isa dhe Abdyli
nga Hasan Prishtina, Ismail Qemali tek Adem Jashari.

Pellazgjia
kishte Promethetë e vet
Iliria kishte Promethetë e vet
Arbëria pat poashtu Promethetë e vet
Shqipëria Etnike ka e do ketë Promethetë e vet.

Vargu
i Prometheve shqiptarë
është i gjatë, i pambarim, i pafund
sepse i pamposhtur është populli që i lindi
e përjetshme toka pellazgo-iliro-shqiptare që i rriti.

E stërlashtë
sa vetë Dheu
e urtë, guximtare
stoike si Prometheu
Shqipëria Etnike rrugëton
nga tejlashtësia nëpër shtigje
çanë përmes historisë së përflakur
ecë rrugës së njerëzimit të përgjakur
marshon mespërmes dritës dhe errësirës
udhëton dhe vrapon me shpejtësi dhe krenari
drejtë lirisë e bashkimit, drejtë ardhmërisë, përjetësisë.

Shqipëria Etnike
është sfidë e pushtuesve e tiranëve
sfidë e neofashistëve dhe neokolonizatorëve
sfidë e kameleonëve, tradhtarëve dhe puthadorëve
të armiqve të vjetër e të rinj të Ballkanit dhe të Europës.

Ashtu
siç ua rrëmbeu
Prometheu zjarrin
"Perëndive" të Olimpit
Shqipëria Etnike po ua rrëmben
përditë e më shumë lirinë dhe trojet
e veta të grabitura, të rrëbyera shovenistëve
dhe barbarëve ballkanas e dredharakëve
europianë.

Shqipëria Etnike
ndër shekuj e mijëvjeçarë
u bë rrufepritësja e ”perëndive” të tokës
u bë flamurtarja kryengritëse e dritës
dhe lirisë
të popujve të Ballkanit, Europës, të Azisë
dhe të botës.

Ashtu
siç e gjuajtën
Prometheun me rrufe
"Perënditë" e egra të Olimpit
ashtu e gjuajtën me zjarr e hekur
me plumba dhe topa armiqtë e pabesë
Shqipërinë tonë etnike, Shqipërinë tonë
stoike.

Kur "Perënditë"
e gjuajtën me rrufe Prometheun
i thanë të dorëzohet se do t'ia falin jetën
ai ua ktheu me vendosmëri atyre
sundimtarëve:

"Nuk i ndërroj vuajtjet
me shërbim prej skllavi!".

Shqipëria Etnike
u tha dhe u thotë armiqve të saj
kur e goditën dhe e godasin për ta
asgjësuar:
"Nuk do të ketë paqë në Ballkan
dhe në Europë,
pa u çliruar dhe bashkuar trojet ilire
të Shqipërisë".

Shqipëria Etnike
antipod i errësirës, është vetë drita
është antipod i robërisë, është vetë liria
është antipod i dorëzimit, frikës dhe
dobësisë
është vetë qëndresa, forca e guximi, Besa
dhe trimëria.

Shqipëria Etnike
është vetë Prometheu.
që u ngritë mbi "Perënditë"
me guximin, bamirësinë, virtytin
ashtu u ngritë e po ngritet vazhdimisht
Shqipëria Etnike mbi padrejtësitë, sulmet
antishqiptare të armiqve sllavo-greko-euro-
aziatikë.

Ndërmjet Prometheut
dhe "Perëndive" të Olimpit
qëndron një hapësirë e madhe
mbushur me bubullima e vetëtima
me rrufe e shkarkime përcëlluese zjarri
mbi trup të tij, mbi popull dhe mbi Pellazgji
Ai qëndroi i pamposhtur, titanik, liridashës
e njerëzor.

Mateshin
kështu rrufetë
e "Perëndive" të Olimpit
me forcën e ideve përparimtare
me atdhedashurinë e zemrën bujare të
Prometheut.

Rrufetë
që hidheshin
kundër Prometheut
u ktheheshin si bumerang
me forca të shumëfishuara atyre
duke i dobësuar e cfilitur për çdo ditë
duke ua shkundur e lëkundur fronin
tiranik
"Perëndive", pushtetarëve e diktatorëve të
kohës.

Midis
Shqipërisë Etnike
dhe barbarëve të panumërt
pushtuesë të të gjitha kohërave
ekziston një mal i tërë me kufoma
një det i thellë me gjak, luftëra e armiqësi.

Dhe ata
që thyen kokën
mbi këtë mal kufomash
heronjsh e heroinash pellazgike
që u mbytën në detin iliro-shqiptar
ishin vetë hordhitë pushtuese euro-aziatike.

Ata
që u mbytën
në detin e gjakut
të Shqipërisë Etnike
ishin vetë ushtarët bisha
të legjioneve të huaja barbare
që sulmonin pandërprer atdheun
e shqiponjave dhe feniksve – Shqipërinë
Etnike.

Edhe sot
Prometheu e Shqipëria
bashkërisht qëlluan dhe qëllojnë,
"perënditë" e botës, tiranët e diktatorët
e të gjitha kohërave që janë ngritur e
ngriten
kundër njerëzimit, lirisë dhe pavarësisë së
popujve.

Zjarri
që rrëmbeu
Prometheu nga "perënditë"
ende flakëron në duartë, në zemrat
në mendjet e njerëzve të lirë e të robëruar të
botës.

Ai zjarr
përcëllon e shkrumbon
në vazhdimësi tiranët, diktatorët
sundimtarët, pushtetarët dhe pushtuesit
e vendeve të lira, të popujve e mbarë
njerëzimit.

Prometheu
i sotëm modern
me pishtarin flakërues në dorë
ngjitet e zbret monopateve të Olimpit
duke goditur vazhdimisht ata që qëndrojnë
ulur
në fronet e pushtetit me duar të përgjakura
në popull.

Liria
dhe robëria
ishin dhe mbetën
në ndeshje dhe përleshje
të ashpër për jetë a vdekje
qenë dhe mbetën antipodi i njëra-tjetrës.

Nuk ka
bashkëjetesë
as pajtim ndërmjet
lirisë e robërisë, viktimës e xhelatit
lufta midis tyre është e lashtë dhe e
përjetshme.

Zjarri
i Prometheut
nuk është thjeshtë zjarr
ai është mbi të gjitha liri, drejtësi
është barazi, paqë e harmoni e njerëzimit.

Zjarri
i Prometheut
është mbijetesë, rezistencë
kundër forcave dhe ligjeve të ashpra
të natyrës e të shtetit, është luftë për
ekzistencë.

Prometheu
simboli i luftës njerëzore
kundër forcave jo humane të natyrës
në agun dhe në muzgun e shoqërisë
parahistorike.

Prometheu
është lufta midis
së mirës dhe së keqes
progresit dhe regresit - dritës dhe errësirës
luftë midis njerëzores e çnjerëzores, lirisë
dhe robërisë.

Prometheu
i përballoi kohës
shekujve e mijëvjeçarëve
i mbijetoi kohërat e sistemet shoqërore
se ai u bë njësh me popullin e vet, me
atdheun e vet.

Mbijetoi
dhe triumfoi
Shqipëria Etnike
trashëgimtarja e Pellazgjisë
fitoi edhe Prometheu, biri i saj trim dhe
besnik.

Shqipëri
dhe Prometheu
u bën një trup i vetëm
duke marshuar sëbashku
përmes stuhive e rrebesheve të kohërave
përballë tiranisë së sundimtarëve e
mohuesve të lirisë.

Prometheu
Krishti i Parahistorisë
është Krishti i Pellazgjisë
që luftoi për liri me forcë e veprim konkret
me shpatë në dorë përhapi dritën, diturinë e
lirinë.

Ua rrëmbeu
me dhunë "zjarrin"
"perëndive" të rrejshme të kohës
ia dha popullit, e vetëdijësoi të mos
gjunjëzohet
përballë tiranisë së sundimtarëve gjakpirës
të Olimpit.

Prandaj
për këtë veprim
njerëzor dhe çlirimtar
Prometheun e dënuan, e gozhduan
dhe e kryqëzua për shkëmbit gjigant të
malit.

Prometheu
është luftëtari
i forcës dhe i shpatës
kurse Krishti është luftëtari
i paqës, i mirëkuptimit dhe i fjalës së urtë.

Dhe të dy
arritën që në popull
dhe në botën njerëzore të asaj kohe
dhe të kësaj kohe të përhapin mesazhin e lirisë
të dashurisë, të drejtësisë, midis njerëzve dhe popujve.

*****

Shqipëria
dhe Shqiptarët
krenohen dhe mburren
me bijtë e tyre trima si Prometheu
dhe luftëtarët tjerë kreshnikë para dhe e pas tij.

Shqipëria
i ka përjetësuar
i ka skalitur në kujtesë
kombi shqiptar i ka ngulitur
në zemër e në mendje bijat e bijtë e tij
luftëtarë si Prometheu dhe i mban në gji
duke lindur Promethe të Rinj, si Prometheu i Vjetër.

Dhe i brumos
me guximin dhe forcën
e tij prej vigani të pamposhtur
duke i rreshtuar përballë armiqve
pushtuesë
dhe ”perëndive” moderne të kohës sonë jo
moderne.

Është
lidhur një Besë
e fortë, e shenjtë, e përjetshme
midis Shqipërisë dhe Prometheve
dhe sa herë që është në rrezik Atdheu,
ata rilindin, ngriten nga shtrati i lëngatës
nga varri, ringjallen e dalin në log të
burrave
në fushëbeteja përballë ”perëndive” e
”bajlozëve”.

Kështu
vepruan përherë
Kreshnikët e Jutbinës
Gjeto Basho Muji e Halili
Gjergj Elez Alia, Konstandini e Ago Ymeri.

Besën
që kishin lidhur
me popullin dhe atdheun
nuk e shkelën, nuk e harruan kurrë
por e çuan në vend, sa herë i thërriste nderi
e liria.

Besa Shqiptare
dhe Dashuria midis
Shqipërisë dhe Bijve të saj
është Fryma Hyjnore që bën lidhjen
e përjetshme midis tyre dhe i bën të
pandarë
viganë, të pavdekshëm në jetë, të gjallë në
vdekje.

*****

PËRMBAJTJA

Vargjet e mia	5
Sonte	8
Ëndrra për Shqipërinë Etnike	9
Dua	11
Urrej	12
Nuk shkruhet	13
Kemi…!	14
Unë dhe Kombi	15
Kot e kanë…	16
Shkruaj…	18
Tokë e mbjellë…	20
Jeta ime	23
Nuk mjafton!	26
Uskana	28
Gjysmë!	30
Rrudhat…!	31
Kryengritësi *(I.Haradinajt)*	33
Kohë e pa kohë!	35
Kemi një…, kemi shumë…	37
Kohët e jetës	39
Ky Shqiptari	41
Zaret u hodhën	42
Sa shumë ”ushtri”!	43
S’kam kohë	45
Nënat tona	47
O Njeri!	49
Mos!	51
Ndreq e prish!	52
Buzëqeshja e ngrirë	53

Mijëvjeçarëve gjak u dhamë 55
O haj, medet!(Elegji) 57
Ne dhe Koha 60
Ky Shekulli i Ri 62
Shqiptarë! 64
Kërkoj… 65
Çamëri, ikonë kombëtare! 67
Atdheu dhe Unë 69
Flamuri i gjakut 72
Disa ditë… *(Monologu i Shqiptarit)* 73
Sa shumë, sa pak! 76
Fjala 78
Jemi bërë… 81
Njerëz-djajtë! 83
Rri i zgjuar 84
Qofsh me jetë, Kosovë dardane 85
Lulja dhe Pranvera 87
Sot… 88
Gjaku dhe Uji 90
Në këtë botë 91
Zjarr… 96
S'është koha, është koha 97
Punët e Zotit 99
Gjurmët tona 100
Shqipëria Etnike 103
Me ty, Poezia ime! 106
Zgjohu, ngritu Shqipëri! 107
Shqipëria dhe Prometheu (Baladë) 111
Përmbajtja 129